

KONTRATË
PËR SHIT - BLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR
TË SHOQËRISË "BionicTech" SH.P.K

Sot, më datë 04.Qeshor.2024 nënshkruhet kjo kontratë për shit-blerjen e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë BionicTech sh.p.k si më poshtë:

Erjona Zogaj shtetase Shqiptare, i identifikuar me letërnjoftim me numër J45422050T, e datëlindjes 22.04.1994, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë "*Shitësi*").

Dhe

Muhamet Zogaj shtetas Shqiptar, i identifikuar me letërnjoftim me numër F90205195B i datëlindjes 05.02.1959 lindur në Plashnik, Berat dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (quajtur më poshtë "*Blerësi*").

MEQENËSE:

- A. **Erjona Zogaj**, dëshiron t'i shesë 100 % të kuotat të kapitalit, që ajo zotëron në shoqërinë BionicTech sh.p.k.
- B. **Muhamet Zogaj** dëshiron të blejë 100 % të kuotave të kapitalit që **Erjona Zogaj** zotëron në shoqërisë BionicTech sh.p.k.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare*", si dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "*Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit*" me ndryshimet e mëvonshme, referuar Statut të Shoqërisë BionicTech sh.p.k. si dhe mbi bazën e *Vendimit të Asamblesë së Ortakëve* të Shoqërisë, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. PËRMBAJTJA E KONTRATËS

1.1. Shoqëria Bionic Tech sh.p.k është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas ligjit shqiptar, themeluar në datë 23.01.2024 me numër unik M41406021N me kapital fillestar themeltar 100,000 (Një qind mijë) Lekë, që zotërohet plotësisht nga ortakut i vetëm, Znj. **Erjona Zogaj**.

Nuk ka ndryshime të mëtejshme të vlerës së kapitalit themeltar apo numrit të kuotave dhe pjesëve të ortakëve.

1.2. Me vendimin e datës 04.06.2024 të Asamblesë së Ortakëve, të kësaj shoqërie, është vendosur miratimi i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar në masën 100% të tyre nga ana e ortakut Erjona Zogaj dhe blerja e tyre nga ana e blerësit, Muhamet Zogaj.

2. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

2.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, shitja e masës prej 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë BionicTech sh.p.k nga ana e Erjona Zogaj dhe blerja e tyre nga ana e Muhamet Zogaj, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë të shitësit, mbi pjesët e kuotave e shitura si pasojë e këtij transaksioni shit-blerje.

2.2. Ndërsa blerësi, Muhamet Zogaj bëhet pronar i kuotave të shitura më sipër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e kësaj kuote, duke fituar kështu cilësinë e ortakut të vetëm në shoqëri.

2.3. Pas realizimit të transaksionit të shit-blerjes së kuotave, kapitali ligjor i shoqërisë përbëhet nga 1 kuota me vlerë përkatësisht 100,000 (Një qind mijë) Lekë, që zotërohet nga ortaku i vetëm Muhamet Zogaj.

3. CMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

3.1. Si çmim i këtij transaksioni Shit-Blerje kuotash të shoqërisë Muhamet Zogaj sh.p.k do të jetë shuma prej 100,000 (Një qind mijë) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë.

3.2. Sipas këtij përcaktimi, blerësi Muhamet Zogaj do të paguajnë në favor të shitësit Erjona Zogaj, shumën në masën 100,000 (Një qind mijë) Lekë.

4. DISPOZITA TË FUNDIT

4.1. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët, të cilat nuk mund të ndryshojnë kushtet e vendosura në të me pëlqimin e tyre.

4.2. Çdo mosmarrëveshje mes tyre palët angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.3. Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqip në përputhje të plotë me vullnetin e lirë të palëve në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

Shitësi
Erjona Zogaj



Blerësi
Muhamet Zogaj



24.06.24